



Pranimar / Dorezuar Primiteno / Prilato Received / Delivery	25-01-2023	3	viti god year
Organ / Bjesia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKUMSHK	878/2023		113



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.1126/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Arditë Haxhnikaj-Demi dhe Eshref Shabani -anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.1126/2022 të datës 09.12.2022 të parashtruar nga ankuesi

kundër organit të punësimit/Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datën 23.01.2023, mori këtë:

**V E N D I M**

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1126/2022 e datës 09.12.2022 e parashtruar nga ankuesi

**A r s y e t i m**

Ankuesi i punësuar në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, më datë 09.12.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 7824/2022 të regjistruar nën shenjen A.nr.1126/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër moszbatimit të Vendimit me numër protokoll 263 të datës 14.01.2021 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës, lidhur me lejimin e ushtrimit të detyrave të Zyrtarit për mbikëqyrjen e provimit për patentë shofer (akzaminer).

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 13.12.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ndërsa më datë 21.12.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokoll 7824/2022 të regjistruar nën shenjen A.nr.1126/2022 në Këshillin e Pavarur

Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin për përfaqësim; Kërkesën për zbatimin e Vendimit të Sekretarit të Përgjithshëm e datës 30.08.2022 e parashtruar nga ankuesi; Akt Emërimit e datës 04.09.2011; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 13.12.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 21.12.2022; Diplomën me Nr. 201 për ankuesin; Diplomën me Nr. 36 për ankuesin; Licencën me Nr. 04/13 të datës 13.09.2013; Licencën me Nr. 08/2018 të datës 30.07.2018; Aktgjykimin A.nr.1807/16 të Gjykatës Themelore në Prishtinë; Vendimin A.nr.740/2018 të datës 08.12.2020 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr. Prot: 263 të datës 14.01.2021 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës; Vendimin me Nr. Port: 8692 të datës 30.10.2020 të Ministrit të Ministrisë së Infrastrukturës; Vendimin me Nr. Prot: 7000 të datës 02.10.2020 të Ministrit të Ministrisë së Infrastrukturës; Vendimin me Nr. Port: 6294 të datës 02.09.2020 të Ministrit të Ministrisë së Infrastrukturës; Vendimin me Nr. Port: 13 të datës 15.07.2020 të Ministrit të Ministrisë së Infrastrukturës; Vendimin me Nr. Port: 5728 të datës 01.07.2021 të zv. Ministrit të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës; Emailin e datës 19.12.2022 nga F.M për L.O; Emailin e datës 14.12.2022 nga L.O për F.M.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës konstatoi së ankesa e ankuesit është e pa bazuar, *sepse:*

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se ankuesi sipas Akt Emërimit të datës 06.09.2011 është i emëruar në pozitën e punës *Ekzaminer* në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Rrjedhimisht, i njëjti me datë 30.08.2022 përmes shkresës me numër SP-02-49587 i është drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, me kërkesë për zbatimin e Vendimit me numër protokollit 263 të datës 14.01.2021, lidhur me lejimin e ushtrimit të detyrave të Zyrtarit për mbikëqyrje të provimit për patentë shofer (ekzaminer), ndërsa kundër heshtjes administrative ankuesi me datë 09.12.2022 parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor për detyrimin e organit përkatës të punësimit që të zbatoj Vendimin me numër protokollit 263 të datës 14.01.2021.

Kolegji i Këshillit nga analizimi i shkresave të lëndës ka gjetur se organi i punësimit gjegjësisht Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në zbatim të Vendimit A.nr.740/2018 të datës 08.12.2020 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 14.01.2021 ka nxjerr Vendimin me numër protokollit 263 për shfuqizimin e Vendimit Nr.3857/2016 të datës 19.07.2016 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave dhe Vendimin Nr.2546/2016 të datës 20.05.2016 të Sekretarit të Përgjithshëm, dhe rrjedhimisht ka kthyer ankuesin në vendin e punës sipas Akt Emërimit të datës 04.09.2011, në pozitën e Ekzaminerit. Ndërsa me Vendimin Nr.5728 të datës 01.07.2021 të Zv. Ministrit të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ankuesi është autorizuar për testimin e kandidateve për shofer nga pjesa Praktike e testimit-Pyetës i Drejtimit, nga rrjedh se pretendimi ankimor i ankuesit se nuk është zbatuar Vendimi me numër protokollit 263 i datës 14.01.2021 nuk qëndron dhe si i tillë është i pa bazuar.

Kolegji i Këshillit lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit për lejimin e ushtrimit të detyrave të ekzaminerit, analizoi dispozitat e Ligjit Nr.05/L-064 për Patentë Shofer përkatësisht nenin 27 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 ku përcaktohet se: 1. Zyrtari, i emëruar nga Ministria, i

cili e mban provimin teorik për patentë shoferi, duhet t'i plotësojë kushtet në vijim: 1.2. të jetë i licencuar si pyetës, dhe nenin 28 paragrafi 1 ku përcaktohet se: 1. *Vlerësimin e kandidatëve për shoferë nga pjesa praktike e kryen personi i licencuar për pyetës, i autorizuar me vendim të ministrit, si dhe dispozitat e Udhëzimit Administrativ (MI) Nr.08/16 për Pyetës, respektivisht nenit 3 paragrafi 1 ku përcaktohet se: 1. Pjesën teorike dhe praktike të provimit për patentë shofer e mban personi i licencuar për pyetës nga Ministria, i autorizuar me vendim të Ministrit, si dhe nenin 18 paragrafi 2 të këtij udhëzimi ku përcaktohet se: 2. Licenca vlen tri (3) vite nga data e dhënies së provimit, dhe si rrjedhojë në kuptim të këtyre dispozitave ligjore shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës nga të cilat konstatoi se ankuesi me datë 30.07.2018 ishte pajisur me Licencë Nr.08/2018 për pyetës të drejtimit me afat vlefshmërie deri me datë 23.07.2021, ndërsa në shkresa të lëndës nuk gjeti ndonjë provë që dëshmon se ankuesi pas datës 23.07.2021 është pajisur me licencë tjetër për ushtrimin e detyrave të pyetësit në provimin për patentë shofer, nga rrjedh se ankuesi nuk ka mundur t'i ushtroj detyrat e pyetësit për patentë shofer pas dates 23.07.2021 ngase të njëjtit i ka skaduar licenca, dhe se angazhimi i tij do të bije ndesh me dispozitat e nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr.05/L-064 për Patentë Shofer si dhe dispozitat e nenit 3 paragrafi 1 të Udhëzimit Administrativ (MI) Nr.08/16 për Pyetës, kështu që pretendimi ankimor i ankuesit në këtë kuptim është i pa bazuar.*

Andaj, për sa me sipër dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIQËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.1126/2022

**Avdyll Bekteshi**

**Procesmbajtës**

**Jeton Koca**

**Kryetar i Kolegjit**

**Vendimi i dërgohet**

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesit;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në MPHI; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.